

SOT NEWS SHPK - K71728004F

1 Informacion i përgjithshëm

Shoqëria **SOT NEWS shp.k.** është regjistruar në Qendren Kombëtare të regjistrimit në 29 Shtator 2003. Veprimtaria e saj sot rregullohet sipas dispozitave perkatëse të ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2008 "Për Tregëtarët dhe Shoqëritë tregtare" dhe nga statuti i saj.

Administratori i shoqërisë është : **z. Arjan PRODANI**

Selia e shoqërisë ndodhet Tirane. **Kashar, Tirane**

Ajo është regjistruar në Degen e Tatim Taksave Tirane me **NIPT K71728004F**

Aktiviteti kryesor i kësaj shoqërie është **botim gazete**.

2 Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare

a. Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara (SKK) dhe ligjin nr.9228, datë 29 prill 2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

Në bazë të urdhrit nr. 64 datë 22.7.2014 "Për shpalljen e standardeve kombëtare të kontabilitetit të përmirësuara dhe zbatimin e detyrueshëm të tyre", Ministria e financave vendosi të bëjë të detyrueshme zbatimin e Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara duke filluar nga 1 janar 2015.

Ky urdhër hyri në fuqi me fletoren zyrtare nr.119, datë 1 gusht 2014.

b. Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

c. Biznesi në vijimësi

Pasqyrat financiare të Shoqërisë përgatiten mbi supozimin e biznesit në vijimësi, i cili merr parasysh se Shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar.

d. Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë paraqitur në Lek, e cila është dhe monedha funksionale e Shoqërisë.


e. Vlerësime dhe gjykime

Paraqitja e pasqyrave financiare kërkon që manaxhimi i shoqërisë të kryejë vlerësime dhe supozime që ndikojnë shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve dhe aktiveve të detyrimeve të kushtëzuara në datën e pasqyrës së pozicionit financiar, si dhe të ardhurave dhe shpenzimeve të krijuara në periudhën kontabël. Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabël janë të njohura në periudhën në të cilën vlerësimi është rishikuar si dhe në periudhat e ardhshme që preken. Në veçanti, informacion mbi fushat më të rëndësishme të vlerësimeve dhe gjykimeve në aplikimin e politikave kontabël të cilat kanë efektet më të rëndësishme në shumat e njohura në pasqyrat financiare, janë përshkruar në shënime të përkatëse të pasqyrave financiare. Përdorimi i vlerësimeve kontabël është minimal në këto pasqyra financiare duke patur parasysh thjeshtësinë e veprimeve të realizuara nga Shoqëria.

f. Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme

Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme bazohet në humbjet e vlerësuara të cilat rezultojnë nga pa mundësia e konsumatorëve për të paguar detyrimet e tyre. Këto vlerësime bazohen në moshën e llogarive të arkëtueshme dhe eksperiencën e mëparshme në çregjistrimin, vlerësimin e aftësisë paguese të konsumatorëve, si dhe ndryshimet e fundit dhe të pritshme të termave të pagesës së konsumatorëve. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme.

g. Krahasueshmëria e informacionit kontabël



Siç paraqitet në Standardin Kombëtar të Kontabilitetit të përmirësuar nr.1, në rastet e një ndryshimi në paraqitjen e pasqyrave financiare si pasojë e kërkesave të një standardi të ri, një përmirësimi në standard apo një ndryshimi në ligjin për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare", informacioni krahasues duhet të riparaqitet për të korresponduar me paraqitjen e re, përveç rasteve kur riparaqitja e informacionit krahasues nuk mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme. Informacioni krahasues për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021 është riparaqitur për të korresponduar me paraqitjen e re të pasqyrave financiare siç kërkohet nga Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuar.

3 Politikat Kontabël

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare.

a. Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivët dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kursi i këmbimit i monedhave të huaja më 31 dhjetor 2022 është detajuar si më poshtë:

<u>Kursi i këmbimit</u>	<u>2022</u>
Euro/LEK	114.23
USD/ LEK	107.05

b. Instrumentat financiarë

Mjetet monetare

Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së fluksit të parasë, mjetet monetare përfshijnë depozita me afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizionit për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Hua të marra dhe të dhëna

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht dhe mbahen në vazhdim me vlerën e tregut, pa përfshirë koston e transaksioneve. Pas njohjes fillestare, huatë e marra dhe të dhëna paraqiten me kosto të amortizuar duke njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve çdo diferencë midis koston dhe vlerës së pagueshme nominale përgjatë periudhës së huamarrjes duke u bazuar (si rregull) në interesin efektiv. Interesat e njohura në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve janë përlogaritur mbi bazën e interesit nominal.

Vlera e drejtë



Vlerat e drejta të përlogaritura të mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar dhe huave, përafrohen me vlerat e tyre kontabël.

Të tjera

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar njihet me vlerën nominale.

Zhvlerësimi i aktiveve financiare

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi. Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit. Aktivet financiare të rëndësishme testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor. Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivet financiare të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

c. Inventarët

Inventarët regjistrohen në kontabilitet me kosto. Kosto e marrjes përfshin të gjitha shpenzimet e kryera për ta sjellë inventarin në vendin dhe kushtet ekzistuese. Në rastin e prodhimit të produkteve në kosto përfshihet edhe pjesa respektive e shpenzimeve të përgjithshme duke u llogaritur mbi kapacitetet normale prodhuese. Kosto e inventarit llogaritet duke përdorur metodën e mesatares së ponderuar. Gjendjet e inventarit janë të vlerësuara në bilanc me koston e tyre historike, duke e konsideruar këtë vlerësim, si vlerën më të ulët midis koston dhe vlerës neto të realizueshme.

d. Aktive afatgjata materiale

Njohja dhe matja

Të gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar. Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivit. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe koston e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivit. Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në "Ndërtim në proces" dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivit kur përfundon ndërtimi tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë. Në rastet kur pjesë të një aktivi afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale. Fitimet dhe humbjet nga shitjet, apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kostot e mëpasshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

Amortizimi



Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën e vlerës së mbetur të amortizimit mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivitetit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivitetet e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivitetit.

Jetëgjatësia e vlerësuar është si më poshtë:

Kategoria e Aktiveve	Metoda e Amortizimit	Norma e Amortizimit
Pajisje zyre informatike	Vlera e mbetur	25%
Mobilje zyre	Vlera e mbetur	20%
Mjete Transporti	Vlera e mbetur	20%
Te tjera	Vlera e mbetur	20%

Çregjistrimi

Një zë i aktiveve afatgjata materiale çregjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëherë kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerrja e tij jashtë përdorimit. Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale, përcaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operativ të vitit.

e. Të ardhurat

Të ardhurat njihen atëherë kur është e mundur që njësia ekonomike do të ketë përfitime ekonomike në të ardhmen dhe këto përfitime mund të maten me besueshmëri. Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të arkëtuar ose të arkëtueshme që merr parasysh shumën e çfarëdo zbritje tregtare, zbritjet për shlyerje të menjëhershme dhe zbritjet e bëra për sasi (vëllim) të blerë.

f. Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit paraqesin të ardhurat që përfitohen jo rregullisht gjatë rrjedhës normale të veprimtarisë ekonomike duke përfshirë, fitim/humbjet nga shitja e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, fitim/humbjet nga rivlerësimet e aktiveve afatgjate të investuara dhe fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit përveç diferencave të këmbimit që lidhen me veprimtaritë financiare dhe investuese.

g. Qiratë

Qiramarrjet klasifikohen si financiare ose operative që në fillimin e qirasë. Qiratë financiare njihen si aktive dhe detyrime financiare në shkallën më të ulët të vlerës së drejtë të aktivitetit dhe vlerës aktuale të minimumit të pagesave të qirasë në datën e blerjes. Kostot financiare regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve nën termin e qirasë me normat e zbatueshme të interesit mbi balancën e mbetur të detyrimeve.

h. Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv. Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet llogarisë fitim/humbje dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

i. Tatimi mbi fitimin



Tatim fitimi i vitit përbëhet nga tatimi aktual dhe tatim fitimi i shtyrë. Tatim fitimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi njihet në kapital. Tatimi aktual është tatimi i pritur për t'u paguar mbi fitimin e tatueshem të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e bilancit, si dhe çfarëdolloj rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme. Norma e tatimit mbi fitimin vitin ushtrimor është 15%.

Tatim fitimi i shtyrë përfaqëson diferencën e tatimit mbi fitimit të pagueshëm (apo të rikuperueshëm) në periudhat e ardhshme, i cili përlogaritet për të evidentuar diferencat e përkohshme që krijohen për shkak të aplikimit të parimeve kontabël të ndryshme nga ato tatimore. Tatimi i shtyrë njihet sipas metodës së detyrimeve të bilancit, duke aplikuar normën tatimore në fuqi mbi diferencën ndërmjet aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të këtyre aktiveve dhe detyrimeve për qëllime tatimore.

Shoqëria nuk ka burim diferencash të përkohshme për njohjen e tatimit të shtyrë mbi fitimin.

j. Fondet për pensione

Shoqëria paguan kontributet ndaj sigurimeve shoqërore e shëndetësore të detyrueshme, që sigurojnë përfitimet për pensione të punonjësve në përputhje me legjislacionin shqiptar. Autoritetet Fiskale janë përgjegjëse për përcaktimin e kufirit minimal ligjor të vendosur për pensionet në juridiksionin përkatës sipas një plani kontributesh pensioni të përcaktuar.

k. Transaksionet me palët e lidhura

Palët e lidhura përcaktohen kur një palë kontrollohet nga pala tjetër, ose ka ndikim të rëndësishëm në vendimet e biznesit apo vendimet financiare të palës tjetër. Për qëllime të paraqitjes së pasqyrave financiare, drejtimi i shoqërisë dhe manaxhimi konsiderohen si palë të lidhura.

l. Provizionet

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë në të ardhmen flukse dalëse parash për shlyerjen e tij. Provizionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet që lidhen me detyrimin në fjalë. Provizionet rishikohen në çdo datë raportimi dhe nëse nuk ka më gjasa për daljen e ndonjë fluksi parash për shlyerjen e detyrimit, provizionet rimerren.

m. Aktivët dhe detyrimet e kushtëzuara

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato paraqiten në shënime të pasqyrave financiare për sa kohë që mundësia për një dalje të burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Një aktiv i kushtëzuar nuk paraqitet në pasqyrat financiare por paraqitet në shënime për sa kohë ekziston mundësia e hyrjes së përfitimeve ekonomike. Shuma e humbjeve të kushtëzuara njihet si provizion, nëse është e mundshme që ngjarjet e ardhshme të konfirmojnë që një detyrim ka lindur në datën e pozicionit financiar dhe mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm i shumës së humbjes.



4 Shenimet Shpjeguese

1 Mjete Monetare	Monedha	31 Dhjetor 2022	
		Vlefte ne leke	Valute e huaj
BKT ne Lek	leke	158,160	
CREDINS ne Lek	leke	83,716	
CREDINS ne Euro	euro	2,752	24.09
CREDINS ne Usd	usd	802	7.49
Totali		245,429	

2 Llogari te arketueshme tregtare	Monedha	31 Dhjetor 2022	
		Vlefte ne leke	Valute e huaj
Internet Advertising	usd	207,149	
Balfin group EU	euro	196,468	
Filiali i Postes	leke	153,647	
Ujesjelles Kanalizime Durres Sha	leke	100,000	
Spar Albania	leke	61,500	
Neptun shpk Eu	euro	45,681	
Credins Sha	leke	36,000	
Neptun QTU	leke	34,269	
Publicita	leke	30,000	
Spar Albania shpk EU	euro	27,415	
Adrion	leke	21,552	
Tirana Bank	euro	20,104	
Ministria e Buqesise dhe Zhvillimit	leke	20,000	
Fondi Shqiptar i Zhvillimit (FSHZH)	leke	17,500	
Marina Di Valona	leke	14,608	
Tirana East Gate TEG	euro	9,138	
Kid Zone shpk	euro	4,569	
Delta Publicity	euro	4,569	
ADG	euro	3,998	
Qendra Tregtare Univers QTU	euro	-3,251	
Totali		1,004,916	

3 Llogari te tjera te arketueshme	Monedha	31 Dhjetor 2022	
		Vlefte ne leke	Valute e huaj
Tatimi mbi fitim	leke	221,130	
Totali		221,130	

4 Inventaret	Monedha	31 Dhjetor 2022	
		Vlefte ne leke	Valute e huaj
Materiale te para	leke	2,352,922	
Totali		2,352,922	



31 Dhjetor 2022

5 Debitorë/Kreditorë	Monedha	31 Dhjetor 2022	
		Vlefte ne leke	Valute e huaj
Debit/Kred tjere Red&Black	leke	3,055,463	
Debit/Kred tjere Classic Print	leke	1,947,272	
Debit/Kred tjere Individidi	leke	20,643,463	
Totali		25,646,198	

31 Dhjetor 2022

6 Aktive afatgjata materiale	Kosto	Monedha	31 Dhjetor 2022		
			Makineri e Pajisje	Te Tjera	Totali
Bilanci i Mbylljes 31.12.2021	AQT Vlera Brut		780,000	1,478,942	2,258,942
Bilanci i Mbylljes 31.12.2021	Amortizimi Akumt		-156,000	-1,133,481	-1,289,481
Bilanci i Celjes 31.12.2021	VLERA NETO		624,000	345,461	969,461
Gjendja më 31 Dhjetor 2021			624,000	345,461	969,461
Amortizimi i vitit			-124,800	-114,130	-238,930
Shtesa				415,470	415,470
Gjendja më 31 Dhjetor 2022	VLERA NETO		499,200	646,801	1,146,001

31 Dhjetor 2022

7 Llogari te tjera te pagueshme	Monedha	31 Dhjetor 2022	
		Vlefte ne leke	Valute e huaj
Te tjera pale te lidhura Red&Black	leke		
Te tjera pale te lidhura Classic Print	leke		
Totali		53,538,796	

31 Dhjetor 2022

8 Llogari te pagueshme tregtare	Monedha	31 Dhjetor 2022	
		Vlefte ne leke	Valute e huaj
Red Black shpk	leke	18,180,876	
Classic Print shpk	leke	14,959,412	
4E Color shpk	leke	606,700	
Neptun shpk	leke	429,540	
Aga & Goxhaj Low firm	leke	99,170	
Celere Shpk	leke	83,496	
Konica Color	leke	52,200	
Media Trans	leke	50,000	
Eagle Mobile	leke	12,407	
BEN.POLYGRAFSNAB JSC	euro	-2,659,274	
Totali		31,814,527	

31 Dhjetor 2022

9 Llogari te pagueshme	Monedha	31 Dhjetor 2022	
		Vlefte ne leke	Valute e huaj
Paga punonjesish	leke	617,210	
Totali		617,210	



		31 Dhjetor 2022	
10 Detyrime tatimore	Monedha	Vlefte ne leke	Valute e huaj
Tatimi mbi te ardhurat personale	leke	1,300	
Totali		1,300	

		31 Dhjetor 2022	
11 Total kapitali	Monedha	Vlefte ne leke	Valute e huaj
Kapitali i paguar	leke	100,000	
Rezerva te tjera	leke	361,422	
Fitimi i pashperndare	leke	-2,397,033	
Humbja e ushtrimit	leke	119,171	
Totali		-1,816,440	

		31 Dhjetor 2022	
12 Te ardhura nga aktiviteti i shfrytezimit	Monedha	Vlefte ne leke	Valute e huaj
Shitje e punimeve e sherbimeve logo r	leke	14,246,622	
Shitje publikime online	leke	5,437,270	
Shitje mallrash	leke	521,740	
Totali		20,205,632	

		31 Dhjetor 2022	
13 Lenda e pare & materiale te konsumuar	Monedha	Vlefte ne leke	Valute e huaj
Blerje/Shpenzime mallrash, shërbimesh	leke	-11,491,495	
Totali		-11,491,495	

		31 Dhjetor 2022	
14 Shpenzime te tjera te shfrytezimit	Monedha	Vlefte ne leke	Valute e huaj
Blerje/Shp Kancelari	leke	-359,417	
Blerje/Shp uji	leke	-5,760	
Blerje/Shp software i fiskalizuar	leke	-7,177	
Taksa e tarifa te tjera	leke	-74,500	
Shpenzime për pritje dhe përfaqësime	leke	-63,668	
Gjoha dhe penalitete	leke	-33,247	
Totali		-543,769	

		31 Dhjetor 2022	
15 Shpenzime paga e shtesa	Monedha	Vlefte ne leke	Valute e huaj
Paga personeli	leke	-6,533,013	
Shtesa mbi page	leke	-1,090,749	
Totali		-7,623,762	

A blue circular stamp with illegible text and a handwritten signature in blue ink are located at the bottom of the page, overlapping the bottom of the table.

16 Shpenzime amortizimi AA	Monedha	31 Dhjetor 2022	
		Vlefte ne leke	Valute e huaj
Amortizimi AA makineri e pajisje	leke	-124,800	
Amortizimi AA materiale Zyre	leke	-62,668	
Amortizimi AA materiale Info	leke	-51,462	
Totali		-238,930	

17 Te ardhura Shpenzime financiare	Monedha	31 Dhjetor 2022	
		Vlefte ne leke	Valute e huaj
Të ardhura/shpenzime nga interesat	leke	-46,685	
Të ardhura/shpenzime te tjera financic	leke	-209,434	
Totali		-256,119	

18 Te ardhura Shpenzime financiare	Monedha	31 Dhjetor 2022	
		Vlefte ne leke	Valute e huaj
Fitim nga këmbimet valutore	leke	67,614	
Totali		67,614	

19 Fitimi/humbja e vitit	Monedha	31 Dhjetor 2022	
		Vlefte ne leke	Valute e huaj
Fitimi/Humbja para tatimit	leke	119,171	
Tatim fitimi	leke	0	
Totali		119,171	

Hartuesi Pasqyrave Financiare
Juelda LAMI

Drejtuesi i njësise ekonomike
ADMINISTRATORI
Arjan PRODANI